

VENDIM
Nr. 828, datë 26.12.2024

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 493, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAVAJË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 493, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 98 003 159,35 (nëntëdhjetë e tetë milionë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 53 000 000 (pesëdhjetë e tre milionë) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 45 003 159, 35 (dyzet e pesë milionë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.”

b) Në pikën 3, togfjalëshi “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohet me “... sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama